



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.969/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevcu anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga Femi Kryeziu, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Malishevë, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Malishevë, paraqitur kundër vendimit Nr.2232-2017 të datës 08.11.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Kuvendet Komunale, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET si i bazuar apeli i Femi Kryeziu, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Malishevë, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Malishevë.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal në Malishevë, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Malishevë, në Vendvotimin 3042A/02D, në Malishevë.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutit e Vendvotimeve si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datë 10.11.2017, nga Femi Kryeziu, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Malishevë, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Malishevë, me të cilën pretendon se në vendvotimin nr. 3042A/02D, në Malishevë, gjatë regjistrimit dhe plotësimit të formularëve 25 vota i janë bartur kandidatëve të tjerë.

Në mbështetje të pretendimeve si provë ka bashkangjitur Formularin e Rezultatit të Kandidatit.

PZAP-i, pas shqyrtimit të se apelit dhe vlerësimit të pretendimeve në apel dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i bazuar

Paneli gjeti se pretendimet ankimore në apel janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, ka vlerësuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit

117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), vendvotimet e cekura në pikën II të dispozitivit të vendimit dhe rezultati i dalur nga rinumërimi të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të datës 22.10. 2017.

Prandaj, më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura miratoj apelin si të bazuar në mbështetje të nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze.*

Nga sa u tha më sipër duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.A.nr.969/2017 me datë 12.11.2017



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.